



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.7.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
GLLOGOCIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Glllogocit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqës Ekipi, Ajtene Llapashtica dhe Anëtar, Ylber Sadiku, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Zukë Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	28
5 Qeverisja e mirë.....	30
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	32
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	34
Shtojca III: Letër konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Glllogocit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 21/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e stafit të komunës, përgjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjës

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Theksim i Çështjës

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 215,834€ ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Regjistrat kontabël të pasurisë nuk janë të plotë, blerjet e pasurisë mbi 1,000€ në vlerë 349,734€ nuk janë evidentuar në SIMFK, si dhe shpalosjet e të arkëtueshmeve saldot fillestare janë nënvlerësuar për 25,448€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të tyre. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Glllogocit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 215,834€ ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Asnjëra nga këto projekte nuk e plotësonte kriterin e përvetësimit të pasurisë për komunën e Glllogocit;
- Projekti¹ i financuar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës me vlerë 329,439€ nuk ishte regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive. Gjithashtu pagesa për projektin² në vlerë prej 20,295€ e ekzekutuar me vendim të gjykatës nuk ishte regjistruar në regjistrin kontabël. Si pasojë regjistri i pasurive është nënvlerësuar për 349,734€; dhe
- Shpalosjet e të arkëtueshmeve ishin nënvlerësuar për 25,448€ si pasojë e mos bartjes së tyre në salldon fillestare (qiraja 3,121€ dhe lejet e ndërtimit 22,327€). Në anën tjetër saldoja e të arkëtueshmeve ishte mbivlerësuar si pasojë e një fature për leje ndërtimi të lëshuar gabimisht (pa kërkesë nga klienti) në vitin 2011 në vlerë 11,122€.

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje me rëndësi të veçantë për auditimin përmendim faktin se detyrimet kontingjente të paraqitura në PFV-të e vitit 2017 në vlerë 76,630€, nuk kishin përfshirë edhe detyrimet kontingjente të bartura nga vitet paraprake në vlerë 302,913. Nëse paditë gjyqësore vlerësohen në favor të operatorëve, organizata mund të ketë implikime buxhetore.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Glllogocit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike,

¹Asfaltimi i rrugës në Fshatin Sankoc – Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Poshtme.

² Furnizimi dhe shtrirja me zhavor në fshatrat e Drenasit.

të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve; dhe
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë, raportet operative (të performancës).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Kryetari, duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit, si dhe të çështjeve kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në planifikimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre të drejtë në PFV.

Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, llogaritë e arkëtueshme si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin financiar janë të vendosura mirëpo nuk janë efikase për kategori të veçanta. Në kontekst të sistemeve financiare, në përgjithësi kontrollet mbi të hyrat por edhe kontrollet në fusha të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtjshëm për të parandaluar parregullsitë në ekzekutimin e pagesave, vonesat në përfundim të projekteve, menaxhimin me pasurinë dhe me llogaritë e arkëtueshme. Fusha e cila ka nevojë për kontrolle shtesë mbetet fusha e prokurimit dhe monitorimi i kontratave tek projektet kapitale.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	13,141,239	13,611,139	12,483,648	11,609,435	12,246,369
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,667,234	11,612,842	11,237,166	10,811,810	11,126,332
Të bartura nga viti paraprak ⁴ -	-	514,669	425,819	142,775	388,144
Të hyrat vetjake ⁵	1,474,005	1,474,005	814,618	634,179	714,020
Donacionet e brendshme	-	9,623	6,045	10,671	16,873
Donacionet e jashtme	-	-	-	10,000	1,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 469,900€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të brendshme dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak.

³ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Niveli i realizimit të buxhetit në komunë ishte në nivel të kënaqshëm. Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar rreth 92% të buxhetit final ngjashëm me vitin paraprak.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	13,141,239	13,611,139	12,483,648	11,609,435	12,246,369
Pagat dhe Mëditjet	7,857,892	7,787,470	7,762,216	7,864,833	7,688,032
Mallrat dhe Shërbimet	1,064,594	1,077,442	966,169	949,262	919,801
Shërbimet komunale	157,860	207,159	205,586	157,267	193,778
Subvencionet dhe Transferet	212,063	216,267	171,737	234,410	264,584
Investimet Kapitale	3,848,830	4,322,801	3,377,939	2,403,663	3,180,174

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje fillimisht ishte rritur me të hyrat vetanake të bartura me vlerë 8,968€, ndërsa vendimi për kursime buxhetore në fund vit ishte në vlerë 79,390€. Përshtatjet e tilla kanë ndikuar që të ketë reduktim buxheti në këtë kategori për 70,422€;
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti final ishte rritur me të hyrat vetanake të bartura për 12,848€. Ndërsa, te shërbimet komunale buxheti final ishte rritur me vendim të qeverisë për 49,300€;
- Buxheti final te subvencionet në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur nga të hyrat vetanake për 4,204€; dhe
- Buxheti i investimeve kapitale ishte ndikuar nga rritjet me të hyrat vetanake prej 489,347€ dhe grantet e donatorëve të brendshëm prej 6,045€.

Në bazë të vendimeve gjyqësore nga thesari janë ekzekutuar gjithsejtë 173 pagesa në vlerë prej 312,408⁶€, prej tyre vendime gjyqësore 189,687€ dhe sipas nenit 39.2 ishin 122,702€. Pagesat me vendime gjyqësore kryesisht kishin të bëjnë me zëvendësimet e punonjësve në sektorin e arsimit, e që në mungesë buxheti dhe vështirësive për përfshirjen e tyre në listat e pagave paguhen me vendime gjyqësore. Ndërsa, në mungesë të mjeteve dhe vonesave në pagesa nga ana e komunës, rezultojnë pagesat direkte nga Thesari që u bëhen operatorëve ekonomik.

⁶ Nga kategoria e investimeve kapitale 195,786€; mallra dhe shërbime 111,564 dhe kategoria e subvencioneve 5,058€.

Çështja 2 – Realizimi i buxhetit dhe keq-klasifikimi i shpenzimeve

E gjetura Procesi i menaxhimit të buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm, mirëpo te investimet kapitale rreth 56% e shpenzimeve është realizuar në tre mujorin e fund vitit, kryesisht për shkaqe të vonesave në realizimin e projekteve. Menaxhmenti nuk analizon në baza të rregullta ecuritë buxhetore kundrejt projekteve të synuara.

Tri pagesa të bëra me marrëveshje për Caritas Kosova me vlerë prej 46,080€⁷ janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve⁸ megjithëse janë të natyrës së subvencionimit. Marrëveshja përcakton ofrimin e shërbimit shëndetësor shtëpiak për familje në nevojë të komunës dhe zonave rurale, të cilat kanë persona të sëmurë dhe të moshuar në familje e që kanë nevojë për përkujdes shëndetësor permanent.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i ndarjeve të mjeteve buxhetore sipas nevojave, ka ndikuar në keq klasifikimin e shpenzimeve. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës, si dhe në mos realizimin e të gjitha projekteve kapitale të synuara për arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi 2 Kryetari, duhet të siguroj që performanca buxhetore monitorohet vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson pengesat dhe vështirësitë për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara⁹ nga komuna në 2017 ishin në vlerë 1,073,197€, këto të hyra komuna i realizon nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe për komunën e Gllogocit të hyrat që i inkasojnë institucionet tjera janë: nga gjobat në trafik 135,153€, dënimet e gjykatës 25,320€ dhe gjobat nga pyjet 85€. Të hyrat nga grantet e donatorëve për këtë periudhë ishin 6,045€.

⁷ Pagesat në vlerë prej 23,040€, 11,520€ dhe një pagesë tjetër prej 11,520€.

⁸ Pagesat Caritas janë bërë nga kodi 13430 shërbime të ndryshme shëndetësore.

⁹ Total të hyrat në vlerë, 1,239,800€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,474,005	1,474,005	1,073,197	1,090,793	893,870
Totali	1,474,005	1,474,005	1,073,197	1,090,793	893,870

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2017 ishte 1,474,005€. Komuna kishte realizuar performancë me realizim të të hyrave prej 73%, të ngjashme me realizimin e të hyrave të vitit të kaluar. Megjithatë, në kontest të çështjeve procedurale, kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja 3 – Dobësi në menaxhimin e të hyrave

E gjetura Komuna nuk kishte arritur të menaxhojë të hyrat e saj në përputhje me kornizën ligjore, si:

- Në mostrën e testuar në vlerë 1,000€ nga pagesa e taksës për leje ndërtimi, pagesa ishte pjesë e borxhit të vitit 2015, që kishte të bënte me taksën prej 22,234€. Komuna, kishte marrëveshje/kontratë me përfituesin që pagesa të bëhej në dy këste. Sipas kontratës kësti i parë ishte paguar ndërsa kësti i dytë është dashur të paguhej deri me datë 15/11/2015. Ndonëse, pjesa e borxhit prej 9,234€ ende nuk ishte paguar nga përfituesi, i njëjti posedon leje ndërtimore;
- Në një rast për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme, komuna kishte kontratë fillestare me përfituesin për 10 vite, më pagesë vjetore 4,000€. Ndërsa, me kontratën e re janë ndryshuar kushtet e kontratës duke zgjatur afatin për 45 vite me pagesë vjetore 1,000€. Kontrata ishte lidhur bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal (KK) për pronën që përcakton sipërfaqen prej 0.15ha (1,500m²), përderisa kontrata e re ishte e lidhur për 2,000m². Komuna, nuk ka ofruar dëshmi për mbajtjen apo jo të konkursit publik¹⁰ për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme me të cilin është lidhur kontrata; dhe
- Sipas rregullës financiare 03/2010, të hyrat e grumbulluara nga organizata buxhetore në fund të ditës duhet të deponohen në bankë së bashku me dokumentin përmbledhës të përcaktuar si numër identifikues UNIREF. Të hyrat e inkasuara në vlerë prej 1,032€ janë deponuar me vonesë për 39 ditë.

¹⁰ sipas rregullores QRK 23/2013

- Rreziku** Mos efikasiteti në inkasimin e të hyrave, vë në vështirësi procesin e realizimit të të hyrave dhe zbatimin e projekteve të cilat financohen nga të hyrat vetjake, gjithashtu ka ndikim në rritjen e llogarive të arkëtueshme. Ndërsa, mos respektimi i procedurave për mbarëvajtjen e ankandit publik ka ndikim në humbjen financiare pasi çmimi në kontratën e re nuk e justifikon ndryshimin jo normalisht të ulët të çmimit të kontratës së re.
- Rekomandimi 3** Kryetari, duhet të sigurojë kontrollë shtesë në menaxhimin dhe raportimin e të hyrave për të siguruar se ato inkasohen, deponohen, evidentohen dhe raportohen sipas kërkesave ligjore, përfshirë kushtet e përcaktuara më kontratë. Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se lidhja e kontratave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës mbështetet në bazë ligjore, njëkohësisht, të rishqyrtoj kontratën dhe të siguroj se janë ndjekur të gjitha procedurat e përzgjedhjes sipas rregullores përkatëse dhe vendimit të Kuvendit Komunal.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Komuna e Glllogocit për vitin 2017 për paga dhe mëditje kishte buxhet në vlerë prej 7,787,469€, derisa ka shpenzuar 7,762,216€ apo 99% të buxhetit final.

Çështja 4 - Dobësitë në menaxhimin e kujdestarive-ndërrimeve të natës

- E gjetura** Në dy raste kujdestaritë-ndërrimet e natës ishin kompensuar 265€¹¹, derisa nga verifikimi i ditareve të kujdestarive-ndërrimeve të natës kemi evidentuar se stafi mjekësor nuk ishin nënshkruar individualisht, por një zyrtar ishte nënshkruar për të gjithë. Kjo dukuri është e shprehur për të gjitha kujdestaritë-ndërrimet e natës përveç mjekëve kujdestarë të cilët nënshkrueshin dhe vendosnin faksimilet.
- Rreziku** Mangësitë e evidentuara në menaxhimin e duhur të ditareve të kujdestarive-ndërrimeve të natës janë tregues i mungesës së efektivitetit të kontrolleve të brendshme në këtë fushë, dhe rrezikojnë përveç në mbi pagesë të kujdestarive edhe në mungesën e shërbimeve më të mira dhe të duhura për qytetarët.

¹¹ Vlera totale e kompensimeve për kujdestari ishte prej 23,633€

Rekomandimi 4 Kryetari, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe me Udhëheqësin e QKMF-së duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrollet adekuate, në mënyrë që të shqyrtojnë dukurinë e identifikuar dhe të aplikojnë kontrolle monitoruese ndaj procesit të aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive-ndërrimeve të natës. Ndonëse, pas këshillave tona gjatë auditimit, komuna ka filluar të ndërmarrë masa, dhe zbatimi i rekomandimit do të rishikohet në auditimin vijues.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i burimeve njerëzore ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve të organizatës për të siguruar funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe të kuvendit komunal, të cilat zbatohen në gjithë organizatën. Menaxhimi i BNj përfshinë: Hartimin dhe rishikimin e strukturës organizative, kategorizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, kontrollin e kostove buxhetore të personelit, si dhe kontrollin e procesit të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të personelit, duke përfshirë këtu edhe matjen e efektivitetit të personelit përmes vlerësimit të performancës së kryerjes së detyrave.

Çështja 5- Kontratat me marrëveshje për shërbime të veçanta dhe UD

E gjetura Komuna gjatë vitit 2017 ka angazhuar 21 punonjës/staf me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV) përmes procedurave të konkursit publik. Shumica e të punësuarave në këtë formë kryesisht janë për pozita të rregullta të punës. Me kërkesë të drejtorive përkatëse, stafit të angazhuar i janë vazhduar kontratat edhe për tre muaj pa procedura konkurruese. Për më tepër, pesë të angazhuarve me MSHV (të punësuar në stacionin e autobusëve si ndërmarrje publike lokale) ju vazhdohet kontrata çdo vit deri në gjetjen e një zgjidhje.

Gjatë vitit 2017 gjashtë pozita kyçe mbuloheshin me ushtrues detyre (UD), tre¹² prej tyre vazhdojnë të jenë ende UD duke tejkalluar afatet e përcaktuara ligjore prej tre muajve. Për më tepër, njëra prej pozitave, për dy muaj ishte udhëhequr nga stafi i cili ishte i angazhuar me MSHV.

Rreziku Angazhimi i stafit me MSHV për pozita të rregullta si dhe mbulimi i pozitave kyçe me UD, mund të rezultojë në jo efikasitet/efektivitet operacional në arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 5 Kryetari, duhet të shqyrtojnë rastet e identifikuara dhe të marrin masat e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të punëtorëve respektohen dispozitat ligjore dhe pozitat e rregullta mbulohen nga të punësuar të rregulltë dhe meritore.

¹² UD-Udhëheqës i Personelit, UD-Shef i sektorit të Inspektionit dhe UD-Shef i sektorit të Kulturës.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 1,284,602€, Prej tyre ishin shpenzuar 1,171,755€ rreth 92%. Këto shpenzime kryesisht përfshijnë shpenzimet komunale, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera.

Çështja 6 – Vonesa në procedurat e prokurimit.

E gjetura Kontrata “Furnizim me artikuj elektrik, veglari, llaqe bujqësor dhe sanitarisë” kishte vonesa në realizimin e procedurave të prokurimit edhe pse inicimi¹³ nga njësia kërkuese ishte bërë me kohë. Po ashtu edhe procesi i vlerësimit të ofertave ishte bërë me vonesë. Kontrata paraprahe për furnizimin e artikujve të njëjtë kishte skaduar më datë 10/04/2017, prandaj deri në lidhjen e re të kontratës me 28/08/2017, komuna ishte furnizuar pa kontratë. Vlera e furnizimit ishte 2,195€.

Gjithashtu te kontrata “Furnizim me pajisje të IT-së” kishte vonesa në realizimin e procedurave të prokurimit edhe pse inicimi¹⁴ ishte bërë me kohë nga njësia kërkuese. Në mungesë të mjeteve të zotuarra kontrata nuk ishte lidhur në komplet vlerën e ofertës së Operatorit Ekonomik (OE) fitues. Vlera e ofertës ishte 26,065€, derisa kontrata ishte lidhur në vlerë 22,066€, me diferencë 4,000€.

Rreziku Vonesat në realizimin e procedurave të prokurimit, mungesa e zotimeve me rastin e nënshkrimit të kontratave rrisin rrezikun e hyrjes në obligime përtej shumës që tejkalon fondet e ndara si dhe ekzekutimin e pagesave të pa rregullta/pa kontratë.

Rekomandimi 6 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që të evitohen vonesat në procedurat e prokurimit dhe që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde për realizimin e tyre. Gjithashtu duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave.

¹³Furnizim me material elektrik, veglari dhe llaqe / Inicimi nga njësia kërkuese datë 31/01/2017. Planifikimi i prokurimit ishte paraparë mars, njoftimi për kontratë qershor 2017 dhe kontrata në gusht 2017. Kontrata paraprahe ka skaduar me datë 10.04.2017.

¹⁴Inicimi nga njësia kërkuese datë 16.03.2017. Planifikimi i prokurimit ishte paraparë prill, njoftimi për kontratë me datë 22.06.2017 dhe kontrata nëntor 2017.

Çështja 7 - Ndarja e Tenderëve

E gjetura Kontratat “Furnizimi me pajisje mjekësore”, “Furnizim me fasha”, dhe “Furnizim me filma për RTG dhe material shpenzues mjekësor” me vlerë të përbashkët 11,943€, janë bërë me procedura të ndara të prokurimit. Për të gjitha kontratat ishte përfitues operatori i njëjtë ekonomik. Te tri kontratat ishin lidhur në tre mujorin e fundit të vitit.

Për kontratën e furnizimit me material shpenzues, kemi testuar pagesën sipas së cilës nuk ishte pranuar i tërë furnizimi sipas kërkesës (kontratës). Komisioni i pranimit kishte pranuar vetëm mallin i cili ishte faturuar. Për më tepër, menaxheri i kontratës ishte drejtori i sektorit të shëndetësisë njëherit edhe autorizues i kërkesës dhe pagesës.

Rreziku Ndarja e tenderëve për t’iu shmangur procedurave të prokurimit paraqet rrezik se do ketë shpenzime më të larta për mallrat apo shërbimet e blera dhe nuk ofrohen mundësi të barabarta për konkurrencën. Autorizuesi i kërkesës dhe pagesës dhe menaxheri i kontratës nga i njëjti zyrtar paraqet konflikt në ndarjen e detyrave.

Rekomandimi 7 Kryetari, duhet të sigurojë se kërkesat e prokurimit duhet të përmbliidhen qartë dhe me kohë nga njësitë kërkuese për të eliminuar nevojën për procedura të shpeshta dhe përdorimin e procedurave minimale dhe kuotimin. Kjo duhet të bëhet duke planifikuar me kohë dhe duke fokusuar në një proces efektiv të prokurimit që siguron vlerën për paranë e shpenzuar. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave si kriter për kontrolle më të mira.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 216,267€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 171,736€ ose rreth 80%. Subvencionet ndahen për entitete publike dhe jopublike.

Çështja 8 – Menaxhimi i Subvencioneve

E gjetura Sipas rregullores për ndarjen e subvencioneve, komuna duhet të lidhë një marrëveshje me përfituesit e subvencioneve. Megjithatë, në pesë raste të testuara kemi evidentuar se komuna nuk ka lidhur marrëveshje të tilla. Po ashtu, rregullorja për ndarjen e subvencioneve nuk përcakton limitet buxhetore që mund të aprovohen nga Kryetari i Komunës.

- Rreziku** Mos aplikimi i marrëveshjeve mes komunës dhe përfituesit, mund të rezultojë me mangësi në realizimin e subvencioneve komfor qëllimit për të cilin është dhënë. Ndërsa mos përcaktimi i limiteve buxhetore që mund të aprovohen nga Kryetari, mund të rezultojë me trajtim jo të barabartë të përfituesve të mundshëm të subvencioneve.
- Rekomandimi 8** Kryetari, duhet të sigurojë se është bërë plotësim ndryshimi i rregullores për menaxhimin e subvencioneve për të përcaktuar limitin buxhetor për aprovimin e subvencioneve nga ana e kryetarit, si dhe të sigurojë se subvencionimi bëhet në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara me rregullore.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,322,801€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 3,377,939€ apo 78%. Investimet kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, ndërtim të shkollave, shpronësime, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja 9 – Mangësi në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të projekteve

E gjetura Ndonëse komuna kishte kontratë me një OE për ofrimin e shërbimeve të “hartimit të projekteve”, megjithatë, kemi vërejtur se në 27 raste, nuk kishte hartuar projektin ekzekutiv¹⁵, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë.

Me tutje, prej gjithsejtë 157 kontratave¹⁶, në 16 prej tyre janë lidhur aneks kontrata në vlerë prej 129,235€ për punë të paplanifikuara dhe punë shtesë të cilat kanë dalë gjatë realizimit të kontratave. Për aneks kontratat janë zhvilluar procedura të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë. Arsyet e numrit të lartë të aneks kontratave janë: zgjatja e rrugëve më kërkesë të banorëve lokal dhe pengesat lidhur me problemet pronësore; zgjatja e rrjetit të kanalizimit për degët anësore të lagjeve për përfundimin e tyre; dhe devijimet e punëve gjatë ekzekutimit të projekteve në teren të cilat kanë rezultuar edhe me kosto shtesë.

Rreziku Inicimi i procedurave të prokurimit në mungesë të hartimit të projektit ekzekutiv, rrezikon vonesa në realizimin e projekteve si dhe kosto shtesë për përfundimin e tyre. Ndërsa numri i lartë i aneks kontratave pa procedura të hapura rrezikon parimin e transparencës dhe konkurrencës si dhe mund të rezultojë me mungesë të mjeteve financiare për realizimin e kontratave aktuale dhe projektet tjera të planifikuara.

¹⁵ UA i KRPP nr. 1/2014 për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë.

¹⁶ 75 prej tyre kontrata për punë.

Rekomandimi 9 Kryetari, duhet të forcoj kontrollet në proceset e planifikimit dhe menaxhimit të projekteve për të siguruar se fillimisht janë hartuar projektet ekzekutive për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë, e më pas të sigurojë një monitorim të rregullt të tyre për të siguruar se punët realizohen në përputhje me kushtet e kontraktuara. Në rastet kur paraqitet nevoja për punë shtesë në raport me ato të kontraktuara, atëherë kontraktimi i tyre duhet të bëhet përmes procedurave të hapura të prokurimit.

Çështja 10 - Mangësi në planet për menaxhimin e kontratave

E gjetura Në nëntë raste verifikuam se drejtori i drejtorisë së Urbanizmit ishte emëruar menaxher i kontratave për projektet kapitale në drejtorinë e tij, përderisa ishte edhe autorizues i pagesave. Gjithashtu në shumicën e rasteve kishte caktuar edhe organin mbikëqyrës dhe komisionin për pranim teknik.

Planet për menaxhimin e kontratave hartoheshin rregullisht, mirëpo mungonte monitorimi i rregullt i tyre dhe plotësimi informata komfor ecurisë së realizimit të kontratave.

Nga ekzaminimet fizike kemi evidentuar një projekt¹⁷ kapital për të cilin ishin kryer pagesa për punë të pa realizuara në vlerë prej 1,470€. Kjo ishte si pasojë e monitorimit të dobët nga ana e organit mbikëqyrës dhe menaxherit të kontratës.

Rreziku Autorizimi i pagesave nga menaxheret e kontratave, paraqet konflikt në ndarjen e detyrave, dhe pagesat për punë të pakryera rezultojnë me pagesa të parregullta. Mos azhurnimi i planit për menaxhimin e kontratës pamundëson pasqyrimin e një gjendjeje reale të realizimit të kontratës.

Rekomandimi 10 Kryetari, duhet të siguroj kontrollet tek autorizimi i pagesave për të siguruar pavarësinë e plotë gjatë autorizimit të pagesave. Në rast të mungesës së stafit të mjaftueshëm të shqyrtohet edhe mundësia e angazhimit të stafit jashtë njësive kërkuese për menaxhimin e kontratave. Më tutje, planet e menaxhimit të kontratave duhet të azhurnohen me kohë në bazë të kryerjes së punëve dhe pagesat realizohen vetëm për punët e përfunduara.

¹⁷Projekti "Asfaltimi i rrugëve në qytezën e Komoranit"

Çështja 11 - Ndryshime të paramasës dhe parallogarisë pa aprovim

E gjetura Në tri raste kemi vërejtur se pa aprovim të Zyrës së Prokurimit dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ kishte pasur devijime apo ndryshime në paramasën dhe parallogarinë e kontraktuar si:

- Kontrata për “Asfaltimin e rrugëve në fshatin Llapushnik, Nënkalimi, lagjja Sopi dhe Lagjja Tahiraj-Haxhijaj” në vlerë prej 35,982€ - Organi mbikëqyrës me aprovim të menaxherit të kontratës kanë bërë modifikimin e paramasës së kontraktuar. Kjo ishte bërë bazuar në kërkesën e banorëve lokal, për përgatitjen e shtruarjes me asfalt të një segmenti tjetër rrugor që nuk ishte pjesë e paramasës së kontraktuar;
- Kontrata për “Kanalizimin e ujërave të zeza në fshatin Shtuticë” në vlerë prej 45,185€, me kërkesën e drejtorit të urbanizmit dhe aprovim të menaxherit të kontratës, është bërë ndryshimi i gypave të betonit me diametër Φ 1000 në gypa me diametër Φ 800 (me qëllim të zgjatjes së metrave të kanalizimit në teren), po ashtu kapakët e metalit janë zëvendësuar me kapak betoni për arsye të mos vjedhjes së tyre; dhe
- Kontrata për “Rregullimin e fushave sportive në fshatin Damanek, Komoran dhe Polluzhë” në vlerë prej 85,373€, me kërkesën e komitetit të fshatit dhe aprovimin e drejtorisë së urbanizmit janë bërë ndryshimet në pikat gjeodezike për ndërtimin e fushës, ndërsa rrethojat e fushës sportive në Polluzhë dhe Komoran nuk janë bërë sipas projektit të paraparë.

Rreziku Ndryshimi i paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar pa aprovimin e zyrës së prokurimit dhe Zyrtarit kryesor Administrativ shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë dhe rrezikon të rezultojë me kosto shtesë.

Rekomandimi 11 Kryetari, duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve do t'i raportojnë Departamentit të Prokurimit për çdo ndryshim nga termat dhe kushtet e kontratës dhe se çdo ndryshim do të bëhet vetëm pas aprovimit të marrë nga Zyra e Prokurimit dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Çështja 12 - Lidhja e kontratave me zotime të pamjaftueshme

E gjetura Në kontratën për “Asfaltimin e rrugës në fshatin Zabel i Ulët, Komoran II dhe Nekoc” në vlerë prej 85,223€ (një kontratë për tri projekte të ndara në PIP gjithashtu zotimet janë bërë ndaras për projekte) kemi vërejtur se zotimi i fondeve për projektin në fshatin Nekoc ishte 19,424€, ndërsa vlera e paramasës së kontraktuar 22,231€.

Gjithashtu te kontrata “Rregullimi i fushave sportive në fshatrat Damanek, Komoran dhe Polluzhë” në vlerë prej 85,373€, (një kontratë për tri projekte të ndara në PIP gjithashtu zotimet janë bërë ndaras për projekte) zotimi i fondeve për projektin në fshatin Polluzhë ishte 20,000€, ndërsa vlera e paramasës së kontraktuar 22,279€. Diferenca për 2,279€ për pjesën që s’ka pas zotim ka mbetur pa u paguar, edhe pse projekti tashmë kishte përfunduar.

Në projektin dy vjeçar i cili ishte bashkëfinancim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për “Asfaltimin e rrugës në fshatin Godanc” në vlerë prej 151,979€ për shkak të pengesave të shkaktuara nga banorët lokal ka pasur ndryshime në projekt të cilat kanë rezultuar me aneks kontratë në vlerë prej 15,198€, i cili është lidhur në mungesë të zotimit. Pagesa për aneks është bërë nga mjetet e ndara për kontratën bazë, përderisa pozicionet e kontratës bazë pritet të barten për ekzekutim dhe pagesë me buxhetin e vitit 2018.

Rreziku Mungesa apo zotimet më të ulëta se paramasa e kontraktuar me rastin e nënshkrimit të kontratave kanë ekspozuar komunën para një rreziku të hyrjes në obligime përtej shumës që tejkalon fondet e ndara si dhe ekzekutimin e pagesave të pa rregullta/pa kontratë.

Rekomandimi 12 Kryetari, duhet të sigurojë kontrollë shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre.

Çështja 13 - Ndërrimi i kodit të projektit me rastin e pagesave.

E gjetura Për projektin dy vjeçar në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës (MI) për “Asfaltimin e rrugës fshatin Baicë – Tërsteniku II dhe ndërtimi i rrugës në fshatin Baicë - lagjia Kiqina dhe Zariqi¹⁸” në vlerë totale prej 250,684€, kemi evidentuar se pagesa në vlerë prej 36,512€ (me aprovim të Kryetarit) është realizuar nga kodi i projektit (44750) lagjia Kiqina dhe Zariqi ndërsa është dashur të paguhej nga MI kodi (15309) asfaltimi i rrugës në Baicë – Tërstenik”. Duhet theksuar se menaxher i kontratës është Drejtori i Urbanizimit, i cili ka caktuar edhe organin mbikëqyrës.

Ndërsa te Projekti për “Renovimin e SHFMU ne fshatin Bytyq dhe ndërtimin e rrethojës në SHFMU Fshatin Gllanasellë” në vlerë prej 3,883€, pagesa totale është bërë nga projekti me kod 44880-Rregullimi i rrethojës SHFMU Gllanasellë.

Rreziku Pagesat e projekteve nga kode jo përkatëse paraqesin pamje jo të drejtë lidhur me realizimin e projekteve kapitale.

Rekomandimi 13 Kryetari, duhet të sigurojë se bëhen planifikime të sakta dhe se të gjitha pagesat e projekteve bëhen sipas kodeve të aprovuara me ligjin e buxhetit apo sipas ri-destinimit të tyre komfor dispozitave ligjore.

Çështja 14 - Vonesa në realizimin e kontratave

E gjetura Nga testimi i pagesave kemi evidentuar pesë pagesa me vlerë 432,861€ në të cilat kishte vonesa në realizimin e kontratave. Vonesat ishin nga 13 deri në 100 ditë pune¹⁹.

Tri kontrata të cilat sipas planit dinamik është dashur të përfundonin brenda vitit 2017 ende (prill 2018) nuk janë përfunduar, si:

- “Asfaltimi i rrugës në fshatin Llapushnik - Drenas, në vlerë prej 252,236€;
- “Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Baicë” në vlerë prej 56,049€; dhe
- “Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Gradicë, Qikatovë e Vjetër, Kizhnarekë dhe ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Polluzhë” në vlerë prej 83,981€.

¹⁸Asfaltimi i rrugës ne Baicë - Tërstenik me Kodin e projektit 15309 financohet komplet nga Ministria e Infrastrukturës në vlerë prej 250,000€, ndarjet buxhetore për vitin 2017 janë 50,000€ ndërsa vlerësimet buxhetore për vitin 2018 janë 200,000€; ndërsa “Ndërtimi i rrugës në fshatin Baicë - lagjia Kiqina dhe Zariqi” me kodin 44750 financohet nga komuna.

¹⁹ Asfaltimin e rrugës në fshatin Dobroshevc, me vonesë 100 ditë; Asfaltimin e rrugës në fshatin Tërsteniku, më vonesë 30 ditë; Asfaltimin e rrugës lokale në Vasileve dhe Poklek i Vjetër, më vonesë 76 ditë; Asfaltimin e rrugës në Fshatin Abri dhe Tërdec, më vonesë 28 ditë; Rregullimin e fushave sportive ne fshatin Damanek, Komoran dhe Polluzhë, me vonesë 48 ditë; si dhe Ndërtimin e urës në Drenas – Baicë, më vonesë ishin 13 ditë pune.

Vonesat në realizimin e kontratave kryesisht ishin për shkak të problemeve me banorët lokal, mungesës së menaxhimit adekuat, mungesës së projekteve ekzekutive, kushteve atmosferike, specifikave të punëve etj.

Rreziku

Vonesat në realizimin e kontratave mund të rezultojnë me mungesë të mjeteve financiare për përfundimin e projekteve sipas kushteve kontraktuale dhe mund të paraqesin pengesë në arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të identifikuara dhe sigurojë që planet dinamike për përfundimin e projekteve kapitale të përputhen me afatet reale të përfundimit të punëve.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2017 ishte 499,026,337€, ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 345,928€. Stoqet në fund vit ishin 6,790€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Çështja 15 - Dobësi në menaxhimin, evidentimin dhe raportimin e pasurisë

E gjetura

Komuna e Drenasit nuk ka arritë të sigurojë kontrolle adekuate në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë. Në kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Në Komunën e Glllogocit pasuria jo kapitale dhe stoqet nuk regjistrohen në sistemin E-pasuria ashtu siç parashihet me rregulloren e aplikueshme për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Të dhënat për këto pasuri mbahen në regjistra te Excel-it, dhe si të tillë nuk na japin siguri lidhur me plotësinë e tyre. Në përgjithësi këto regjistra janë të mangëta dhe nuk ofrojnë informacione detale mbi pasuritë të tilla si: numri serik, barkodi, data e pranimet etj;
- Në regjistrin kontabël ne identifikuam gabime në regjistrimin e pasurisë kapitale të dy projekte. "Projekti "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Poshtme" në vlerë prej 36,264€, është regjistruar si investim në vijim ndonëse projekti ishte pasuri në përdorim; dhe
- Komisionet për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë, kishin hartuar raportet individuale lidhur me inventarizimin e pasurisë së komunës, mirëpo nuk kishin hartuar një raport përmbledhës për pasuritë, duke përfshirë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara.

Rreziku Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që e posedon si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë në pasqyra financiare. Mos inventarizimi i plotë i pasurisë, shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të pasurisë, duke rrezikuar njëkohësisht keqpërdorimin apo humbjen e pasurive.

Rekomandimi 15 Kryetari, duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Në këtë aspekt duhet të sigurojë kontrolle në evidentimin e pasurisë jo kapitale si dhe të sigurojë funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve. Më tutje, të sigurojë se pas procesit të inventarizimit gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.

3.9 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Në PFV janë paraqitur vlerat e katër avanseve të pambyllura në vlerë prej 4,170€, prej tyre tri rezultuan se janë të mbyllura me 15/01/2018, dhe një avans ka mbetur i hapur në vlerë prej 3,000€.

Çështja 16 – Avanset e pambyllura

E gjetura Në kuadër të avanseve të pambyllura në fund të vitit, avansi me vlerë 3,000€, i tërhequr me datë 07/07/2017, ende ka mbetur i pambyllur për shkak të mungesës së dëshmive. Kërkesa, vendimi dhe pranimi i mjeteve janë bërë nga i njëjti person. Në dosje mungonin ftesa zyrtare për udhëtim dhe lista e pjesëmarrësve. Faturat për akomodim nuk përkonin me datat në agjendën e udhëtimit. Dy dëftesa tatimore (jo fatura) për fjetje në vlerë 428€ ishin pa vulë dhe pa datë. Këto ishin edhe arsyet e mos mbylljes së këtij avanci.

Rreziku Mos arsyetimi i avanseve, tregon se komuna ka kontrolle jo efektive në këtë fushë, në anën tjetër derisa mjetet janë të paarsyetuara, vë në pasiguri se shpenzimi ka ndodhur dhe të rezultojë me keq menaxhim apo humbje të parasë publike.

Rekomandimi 16 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në trajtimin/menaxhimin e parasë së gatshme të komunës. Duhet siguruar se avanset mbyllen brenda afatit të përcaktuar kohor në pajtueshmëri me UA që e rregullon këtë çështje. Më tutje, rasti i përmendur, të rishikohet dhe të përmbillet me procedurat e parapara.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PFV në fund të vitit ishin 2,427,920€. Strukturën e të arkëtueshmeve e përbëjnë: tatimi në pronë, taksa në biznes, qiratë dhe lejet e ndërtimit. Pjesëmarrjen më të madhe në këtë strukturë e kanë të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 1,354,200€ dhe të arkëtueshmet taksa në biznes 1,003,040€.

Shpalosjet e të arkëtueshmeve në vitin 2016 ishin 282,850€ ndërsa këtë vit 1,003,040€. Rritja enorme e saldove prej vitit të kaluar ka ardhur si rezultat i veprimeve të ndërmarra për ngarkesat të cilat nuk ishin kryer me kohë, dhe këtë vit janë ngarkuar bizneset për taksat e viteve paraprake.

Çështja 17 - Llogaritë e arkëtueshme / tatimi në pronë

E gjetura Nga mostrat e testuara për llogaritë e arkëtueshme te tatimi në pronë kemi vërejtur parregullsi si:

- Një rast ka rezultuar me gabim në faturim si shkak i sistemit, ishte faturuar çmimi 210€ në vend të 200€ sipas rregullores; dhe
- Në tetë raste, nuk janë aplikuar ndryshimet në bazë të koeficientit të kualitetit tek faturimet, sipas rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017.

Megjithatë, komuna kishte ndërmarrë masa dhe ju kishte dorëzuar vërejtje me shkrim palëve me mbi 1,000€ obligime, ku ju kishte ofruar edhe mundësinë e pagesës me këste.

Rreziku Gabimet e evidentuara tregojnë kontrolle jo efektive në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, kjo situatë nuk jep siguri se të dhënat e gjeneruara në sistemin e tatimit në pronë janë të plota dhe të sakta.

Rekomandimi 17 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë. Në këtë aspekt të sigurojë se do t'i eliminojnë të gjitha gabimet në sistemin e tatimit në pronë si dhe sigurojë mekanizma efektiv për mbledhjen e të tyre, përfshirë edhe ushtrimin e masave ligjore për mbledhjen e tyre.

Çështja 18 - Llogaritë e arkëtueshme / taksat në biznes

E gjetura

Për llogaritë e arkëtueshme të taksave në biznes kemi vërejtur:

- Në tri raste, bizneset të cilat lirohen nga taksat me rregullore prej vitit 2014, të njëjtit nuk ishin ngarkuar me taksë për vitet 2004-2014;
- Me rastin e ndërrimit të veprimtarisë së biznesit nga NSH në SHPK (ishte hapur kartelë e re e klientit) nuk ishte bartur edhe borxhi me vlerë 500€; dhe
- Në një rast ishte faturuar gabimisht me taksë biznesi 20,000€ në vend të 200€.

Programi me të cilin menaxhohen këto llogari është i mangët dhe nuk ofron informata të mjaftueshme për menaxhim. Programi nuk ofron saldot fillestare, ngarkesat e vitit (të përmbledhura), por ofron mundësi vetëm për gjendjen e klientëve individualisht (ngarkesat, pagesat dhe gjendjen përfundimtare). Ndryshimet e bëra nga stafi nuk lejnë gjurmë në program, mund të shtohet një pagesë apo edhe të fshihet dhe nuk regjistrohet data e ndryshimit.

Vlen të ceket se komuna në vitin 2017 nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të zvogëluar llogaritë e arkëtueshme për taksat e biznesit. Veprime ishin ndërmarrë për azhurnimin e ngarkesave të bizneseve, pasi të njëjtit nuk ishin ngarkuar në baza vjetore me taksa. Kjo ka bërë që saldoja e llogarive të arkëtueshme për taksat në firma të rritet me vlerë prej 720,190€.

Rreziku

Mungesa e kontrolleve adekuate dhe gabimet me menaxhimin e programit, vejnë në rrezik sigurinë dhe plotësinë e të dhënave të llogarive të arkëtueshme të komunës. Njëherit, komuna mund të mos ketë informata të sakta për planet e saja apo masave që duhet të ndërmerren në këtë fushë.

Rekomandimi 18

Kryetari, duhet të sigurojë kontrollet për menaxhimin adekuat të këtyre llogarive të arkëtueshme, avancimin/sigurinë e programit me të cilin menaxhohen llogaritë. Duhet forcuar kontrollet ashtu që bizneset të ngarkohen me taksa në baza të rregullta vjetore në bazë të rregullores për taksa si dhe të sigurojë se merren të gjitha veprimet për inkasimin e plotë të tyre.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 37,310€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Po ashtu komuna kishte edhe detyrime kontingjente në vlerë 76,630€. Dobësitë lidhur me raportimin e detyrimeve kontingjente i kemi shpalosur të kapitulli 2.1 të çështjet kyçe të auditimit.

Çështja 19- Vonesat në pagesa si dhe dobësitë në raportimin e obligimeve

- E gjetura** Rregullorja financiare 02/2013 MF, neni 5 përcakton periudhën e raportimit mujor të obligimeve të papaguara në Ministrinë e Financave-Thesar, përderisa komuna për muajin nëntor nuk kishte raportuar obligimet e saj.
- Me tutje, obligimi/fatura e testuar në raportimet e muajit dhjetor me vlerë 2,860€, ishte raportuar si obligim gabimisht për furnizimin të cilin nuk e kishte pranuar komuna²⁰.
- Po ashtu në dy mostra të testuara kemi identifikuar vonesa në pagesa prej 34 deri në 59 ditë mbi afatin kohor të përcaktuar për pagesë.
- Rreziku** Kontrollat e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve, reflektojnë në raportimin jo të plotë dhe jo të drejtë të obligimeve. Pranimi/raportimi i faturës për furnizimet që nuk janë pranuar rrezikon hyrjen në obligime fiktive të komunës.
- Rekomandimi 19** Kryetari, duhet të forcojë kontrollat në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas pranimi të faturës. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 ka rezultuar me 18 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, mirëpo raporti i ZKA-së si dhe progresi lidhur me zbatimin e planit të veprimit të rekomandimeve të auditimit nuk ishte diskutuar në Asamblenë Komunale.

Deri në fund të auditimit tonë, prej 18 rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit 2016, katër rekomandime janë zbatuar; tetë janë pjesërisht të zbatuara dhe gjashtë nuk janë zbatuar. Ndërsa, tri rekomandime të vitit 2015 edhe më tej mbesin të pa zbatuara (ref: Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe vitet e mëhershme).

²⁰ Komuna ishte faturuar për vlerën komplet të kontratës 4,780€, përderisa procesverbali nga komisioni i pranimi aprovonte pranimin e vlerës 1,920€.

Çështja 20 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Edhe pse janë zbatuar kërkesat për të hartuar një plan veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016, progresi lidhur me zbatimin e planit të veprimit nuk ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Si rrjedhojë e menaxhimit jo efektiv të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve, vetëm një pjesë e ulët e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Menaxhmenti i komunës nuk aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve (shih shtojcën II).

Kryesisht, rekomandimet që po përsëritën nga viti në vit janë:

- Mos verifikimi i 1/3-ës të pronave²¹ i cili mund të rezultojë me informata të paplota për pronat;
- Angazhimi i punëtorëve²² jashtë planifikimit buxhetor në mungesë të buxhetit të aprovuar; dhe
- Mangësitë në menaxhimin e projekteve kapitale dhe menaxhimin e të hyrave vetjake dhe të arkëtueshmeve.

Rreziku Përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar në mos efikasitet të vazhdueshëm përderisa rekomandimet e dhëna nuk adresohen.

Rekomandimi 20 Kryetari, duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioritetëve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.

²¹ Prej 14,459 prona të regjistruara në komunën e Glllogocit, prej tyre janë verifikuar vetëm 668 prona.

²² Për vitin 2017 ishin të angazhuar 33 punonjës.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Procesi i dobët për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të vitit paraprak, ekzekutimi i buxhetit në nivel të ulët për investime kapitale, mungesa e proceseve monitoruese për menaxhimin e rrezikut dhe kontrolle të dobëta mbi shpenzimet dhe të hyrat janë disa nga dobësitë e identifikuara në qeverisje.

Komuna me kohë kishte përmbushë kërkesën për dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit në MF. Megjithëse, njëra nga çështjet e pyetësorit e cila kishte të bënte me proceset efektive të monitorimit lidhur me progresin e objektivave, konsiderohet si të vendosur nga ana e komunës mirëpo, nuk na janë ofruar dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve.

Gjithashtu për vitin 2017 sistemi për menaxhim të rreziqeve ishte vendosur por nuk ishin paraparë veprimet monitoruese për mbikëqyrjen e aktiviteteve për menaxhimin e rreziqeve.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB-së dhe një auditor. NJAB kishte hartuar planin strategjik edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë disa auditime për vitin 2017. Përveç NJAB është i themeluar edhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Komiteti ka mbajtur katër takime të rregullta në vitin 2017.

NJAB për vitin 2017 kishte planifikuar dhe finalizuar shtatë raporte të auditimit, gjithashtu kishte finalizuar edhe një raport me kërkesë të veçantë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 21 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Rrjedhimisht pasqyrat financiare vjetore kanë rezultuar me pasaktësi dhe gabime. Trajtimi i disa zërave nuk ka qenë adekuat, si të klasifikimi i shpenzimeve në PFV, bartja e saldoeve fillestare të llogaritë e arkëtueshme, si dhe regjistrat e paplota të pasurive.

Sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, komuna duhet të ketë një sistem për menaxhim të rreziqeve. Për vitin 2017 ky sistem ishte vendosur por nuk ishin paraparë veprimet monitoruese për mbikëqyrjen e aktiviteteve për menaxhimin e rreziqeve.

Rreziku Kërkesat e llogaridhënies dhe raportimi financiar duhet të forcohen për të përkrahur efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, saldot fillestare duhet të rishikohen dhe verifikohen në mënyrë që informacioni financiar të jetë i krahasueshëm dhe i plotë në funksion të konsistencës dhe mbi të gjitha ta përkrahë vendimmarrjen.

Rekomandimi 21 Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA (e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në theksim të çështjes. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet për mos regjistrim të duhur të shpenzimeve në kategoritë adekuate, respektivisht që shpenzimet dhe pagesat nga palët e treta të regjistrohen në mënyrë të drejtë.		Edhe për vitin 2017 kemi theksim të çështjes për çështjet që kanë të bëjnë me keq klasifikimet e shpenzimeve.	
	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.		Komuna ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo pavarësisht kësaj një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve kanë mbetur të pazbatuara.	
	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për mënyrën e tanishme të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura në drejtoritë e komunës dhe të zbatoj forma më të mira për arritjen e objektivave të synuara.		Përkundër përmirësimeve të kontrollit, edhe me tutje disa nga linjat e raportimit nuk janë duke funksionuar sipas dizajnit.	
	Kryetari duhet të siguroj se do të bëj një planifikim të mirëfilltë të buxhetit, forcojë një disiplinë financiare për kryerjen e pagesave me kohë si dhe do t'i rishikoj të gjitha obligimet e pa paguara në mënyrë që të evitohet vonesat në kryerjen e pagesave.			Nuk janë marrë masa.

	<p>Kryetari duhet të siguroj monitorim sistematik të performancës buxhetore dhe të forcoj disiplinën financiare në mënyrë që obligimet të paguhen me kohë dhe jo përmes procedurave të detyrueshme ligjore. Komuna duhet të jetë më e përkushtuar sidomos në përmirësimin e performancës në ekzekutimin e buxhetit për investime kapitale.</p>			<p>Nuk janë marrë masa.</p>
	<p>Kryetari duhet të inicioj një analizë të plotë pse janë aplikuar praktika të dobëta të prokurimit në këto raste dhe të zbatojë kontrole të shtuara të cilat sigurojnë se: prokurimet i reflektojnë nevojat; specifikacionet e tenderit i reflektojnë kërkesat aktuale; dhe furnizimet i përmbushin kërkesat e njëjësive kërkuese.</p>		<p>Përkundër përmirësimit të kontrolleve në fushën e prokurimit, edhe me tutje një numër i dobësive janë evident ende.</p>	
	<p>Kryetari duhet të siguroj që kjo çështje të trajtohet nga të gjithë akterët e përfshirë në këto procese, siç është Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Qeveria, për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për këtë problem. Përveç kësaj, nevojitet një planifikim më i mirë i stafit gjatë procesit buxhetor.</p>			<p>Nuk janë marrë masa.</p>
	<p>Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave të konsiderueshme dhe të ndërmerr veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.</p>		<p>Komuna kishte ndërmarrë hapa duke bërë përpjekje për mbledhjen e të arkëtueshme nga tatimi në pronë, mirëpo edhe me tutje niveli i tyre është i lartë.</p>	


	Kryetari duhet të sigurojë se aranzhimet duhet të jenë më të avancuara për të konsoliduar plotësinë e obligimeve dhe të kërkoj nga zyrtarët përgjegjës përcjelljen e faturave të pa paguara tek departamenti i financave. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente, në koordinim me përfaqësuesin ligjor të komunës, duhet të ndërmerren një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, për të shmangur mundësinë e ekzekutimeve direkte nga MF.		Komuna ka shënuar progres në menaxhimin e obligimeve, megjithatë, ende nuk ka arritur të evitoj obligimet e mbetura nga viti paraprak.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i korrigjuar gabimet në kontabilitet për të siguruar regjistrim të saktë të pasurive dhe shpalesje të plotë të llogarive të arkëtueshme.		Përkundër përmirësimit të raportimit edhe në PFV-të e vitit 2017 kemi identifikuar disa parregullsi lidhur me regjistrat e pasurive dhe shpalesjen e të arkëtueshmeve.	
1. Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive të rishikimit të draft PFV-ve nga menaxhmenti. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioritetëve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka nevojë, të propozohen masat adekuate.		Komuna ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo pavarësisht kësaj një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve kanë mbetur të pazbatuara.	

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	Kryetari duhet hartoj planet aksionale për zbatimin e strategjive të komunës, si dhe në periudha adekuate të kryej rishikimin për dinamikën e realizimit të tyre.		Komuna ka ndërmarrë hapa në këtë drejtim, kishte hartuar planin e integritetit 2017-2019	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se segmentet e potencuara të menaxhimit duhet të rishikohen dhe verifikohen në mënyrë që informacioni financiar të jetë i krahasueshëm dhe i plotë në funksion të konsistencës, dhe mbi të gjitha ta përkrahë vendimmarrjen për përmirësimin e performancës në drejtim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve.		Raportimi financiar nuk e ka mbështet shpalosjen e saktë të shënimeve. PFV janë paraqitur në mënyrë të drejtë, përveç saldoeve ku edhe këtë vit janë paraqit me nënvlerësim.	
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	Kryetari duhet të siguroj që analizat buxhetore, në veçanti të investimeve kapitale të bëhen në baza mujore dhe aty ku identifikohen barrierat dhe vonesat, të ndërmerren veprimet e duhura për të maksimizuar shpenzimet dhe realizimin e projekteve kapitale në nivelin e planifikuar.		Në raport me vitin paraprak niveli i investimeve kapitale është rritë për 7%, mirëpo edhe në këtë vit kishte vonesa të shumta në realizimin e projekteve.	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë siç kërkohet me udhëzimin administrativ. Po ashtu, duhet të sigurojë se barazimet ndër departamentale kryhen në baza të rregullta mujore.			Nuk janë marrë masa.
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të trajtoj këtë çështje me prioritet, të siguroj se është bërë një rishikim i procesit të angazhimit të tyre. Çështja e stafit zëvendësues duhet të diskutohet edhe me Ministrinë e Financave, në mënyrë që të mos shfaqen deficite buxhetore te pagat. Përveç kësaj, nevojitet të bëhet një planifikim më i mirë i stafit përgjatë vitit buxhetor.			Nuk janë marrë masa.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të analizoj arsyet pse rastet e mësipërme kanë ndodhur dhe të sigurojë se komuna do të ndjekë procedurat e prokurimit për kontraktimin e të gjitha shërbimeve dhe nuk do të paguaj për shërbime të cilat nuk ka kontrata valide.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të hulumtoj arsyet pse pagesa nuk është kryer gjatë tri viteve të kaluara, të forcoj kontrollet financiare për të siguruar se pagesat bëhen me kohë dhe klasifikimi bëhet sipas kategorive ekonomike përkatëse të përcaktuara në planin kontabël.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.	Po		
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që zyrtari i shpenzimeve e bën klasifikimin e duhur të shpenzimeve sipas planit kontabël dhe shpenzimet regjistrohen nëpër kodet përkatëse.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UA i KRPP nr. 1/2014 për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Po ashtu, pasi që komuna veç e ka kontraktuar këtë shërbim, të përdor të njëjtin për të aplikuar një koncept më ekonomik të administrimit të procesit dhe të jetë në pajtim me kërkesat e rregulloreve.			Nuk janë marrë masa.

3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet për lidhjen e këtyre kontratave të pafavorshme për komunën dhe të siguroj se njësitë kërkuese të prokurimit, para se të iniciojnë procedurat, bëjnë një analizë të detajuar të vlerësimit të nevojave, duke siguruar se në specifikacionin teknik nuk përfshihen pozicione të cilat janë të panevojshme.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim i procesit të mbikëqyrjes së projekteve kapitale nga përgjegjësit relevant të komunës, dhe të merr masa adekuate aty ku mbikëqyrja nuk ka dhënë rezultatet e pritura.		Proceset e mbikëqyrjes së kontratave janë evidente megjithatë ka pasur progres.	
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet t'i analizoj në hollësi çështjet pse shërbimi i prokurimit nuk ka zbatuar me konsistencë dispozitat e kontratave, dhe të shqyrtoj arsyet pse kontrollet e certifikimit kanë dështuar të parandalojnë pagesat e kryera jashtë kushteve të përcaktuara me kontratë. Masa shtesë të kontrolleve duhet vendosur për të siguruar se rastet e tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen.		Disa çështje janë përmirësuar, mirëpo janë evidentuar pagesa që janë bërë për punët e pa realizuara gjatë ekzaminimi fizik.	
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur kontrolle të përmirësuara dhe më efektive, në mënyrë që evidentimi dhe pasqyrimi i saldove të llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë. Gjithashtu, duhet iniciuar një proces rivlerësimit për të gjitha llogaritë e arkëtueshme dhe të analizohen mundësitë reale për inkasim			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se në PFV paraqiten të gjitha obligimet e komunës dhe ekzekutimi i pagesave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj dhe rregulloret shoqëruese.		Ende ka vonesa në pagesa, dhe për muajin nëntor nuk ishin raportuar obligimet në thesar.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Glllogocit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, pos disa sqarimeve që i kemi parë të arsyeshme si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Glllogocit

Data: 30.Maj.2018, Glllogoc,

